

REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM
Nr. 145, dt. 16.07.2015

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren e miratuar me vendim të KKR nr.75, dt.03.04.2015 “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licencave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, në mbledhjen e datës 16.07.2015, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, pasi shqyrtoi kërkesën për pajisje me licencë në fushën e restaurimit për shoqërinë “ATELIER 4” sh.p.k., me drejtues teknik z. Alban Efthimi me licensë personale restaurimi R.P.49,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “ATELIER 4” sh.p.k me drejtues ligjor z. Altin Premti dhe z. Alban Efthimi për pajisje me licencë në fushën e restaurimit për kategorinë: **CP.”Projektim për restaurim në monumentet e arkitekturës për shoqëri projektimi”.**
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, miratimin e kërkesës për pajisje me licencë restaurimi për shoqërinë “ATELIER 4” sh.p.k për kategorinë **CP.”Projektim për restaurim në monumentet e arkitekturës për shoqëri projektimi”** me drejtues teknik z. Alban Efthimi.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI



KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

